VENDIM
Nr. 789, datë 15.12.2021

PËR KRITERET, MËNYRËN E SHPËRBLIMIT DHE TRAJTIMIN E SPORTISTËVE, QË PËRFITOJNË STATUSIN E NIVELIT TË LARTË, DHE TRAJNERËVE TË TYRE

(Ndryshuar me VKM nr. 167, datë 20.3.2024; nr. 631, datë 10.10.2024; nr. 829, datë 30.12.2025; nr. 296, datë 24.4.2026)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 27, të ligjit nr. 79/2017, "Për sportin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kritereve për përfitimin nga sportisti të statusit të nivelit të lartë, sipas rezultateve të arritura në veprimtaritë ndërkombëtare apo kombëtare. Klasifikimi i këtyre rezultateve në veprimtaritë ndërkombëtare dhe kombëtare jepet sipas tabelave I dhe II, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Sportistët mbajnë statusin e nivelit të lartë nga momenti i marrjes së rezultatit zyrtar në veprimtaritë ndërkombëtare apo kombëtare deri në marrjen zyrtare të rezultatit nga një sportist tjetër pasardhës në atë sport.

3. Sportistët, që gëzojnë statusin e nivelit të lartë, përfitojnë shpërblim dhe trajtim, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

4. Masa e shpërblimit financiar *për sportet olimpike*, për çdo rezultat të arritur, jepet sipas tabelave I e II, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, e jepet pas shpalljes së rezultateve përfundimtare zyrtare të veprimtarisë sportive nga federata ndërkombëtare/kombëtare e atij sporti. *Për sportet joolimpike, shpërblimi financiar është në masën 70 (shtatëdhjetë) % të vlerave të përcaktuara në tabelën I dhe në masën 100% të vlerave të përcaktuara në tabelën II.*

4/1. Sportisti shpërblehet financiarisht vetëm për një rezultat sportiv të arritur për secilën nga veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare: lojëra olimpike, kampionat botëror, kampionat evropian, lojëra mesdhetare dhe kampionat ballkanik, gjatë vitit kalendarik, në një disiplinë, sipas tabelës I. Në sportet individuale, të cilat kanë stile të veçanta dhe më pas një rezultat përfundimtar, shpërblimi për çdo stil të veçantë do të jetë në masën 65%, me kushtin që të jetë i klasifikuar në rezultatin përfundimtar, si dhe 100% për rezultatin përfundimtar.

4/2. Në sportet individuale, ku garimi është në çift ose ekipor, shpërblimi do të akordohet sipas tabelës I dhe do të përpjesëtohet sipas numrit të pjesëmarrësve. Sportet joolimpike shpërblehen sipas tabelës I, kur në kampionatin botëror garojnë më shumë se 8 (tetë) sportistë, në kampionatin evropian ka më shumë se 6 (gjashtë) sportistë, në lojërat mesdhetare, më shumë se 4 (katër) sportistë, dhe në kampionatin ballkanik, më shumë se 4 (katër) sportistë.

5. Integrimi i sportistëve në sistemin arsimor me drejtim sportiv, i sigurisë kombëtare e mbrojtjes dhe punësimi i tyre në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme përfitohet vetëm 1 (një) herë brenda periudhës së përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi.

6. Sportistët e sporteve individuale, të kategorisë "të rinj", që arrijnë rezultate në veprimtaritë ndërkombëtare, sipas tabelës I, shpërblehen në masën 30 (tridhjetë) % të vlerës së përcaktuar për kategorinë "të rritur". *Kategoria "të rinj" përcaktohet nga niveli "Junior Championship" i kampionatit ndërkombëtar ose në moshat U-16, U-17, U-18, U-19 vetëm në*

rastet kur mungon kategoria "Junior Championship" në federatat përkatëse ndërkombëtare.

7. Trajnerët e sportistëve, që kanë përfituar statusin e nivelit të lartë, sipas këtij vendimi, shpërblehen në masën *50 (pesëdhjetë) %* të vlerës që përfiton sportisti me këtë status.

8. Sportistët e nivelit të lartë dhe trajnerët e tyre, pjesëmarrës në veprimtaritë kombëtare, të përcaktuara në rregulloret e federatave sportive përkatëse dhe në veprimtari ndërkombëtare, për përgatitjen e tyre përfitojnë trajtim ushqimor në natyrë ose në vlerë, si dhe trajtim mjekësor.

9. Trajtimi ushqimor është *jo më pak se 5 000 (pesë mijë) lekë* në ditë, për 25 (njëzet e pesë) ditë në muaj.

10. Shpenzimet për trajtimin mjekësor vlerësohen sipas dokumenteve justifikuese për periudhën e trajtimit.

11. Trajtimi ushqimor e mjekësor për periudhën e grumbullimit dhe të pjesëmarrjes në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare të sportistit, sipas tabelës I, në përbërje të ekipit përfaqësues kombëtar, mbulohet nga federata sportive përkatëse.

12. Efektet financiare për shpërblimin e trajtimin e sportistëve të nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre, në sportet individuale, që arrijnë rezultate në veprimtaritë ndërkombëtare, sipas tabelës I, përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për ministrinë përgjegjëse për sportin. Masa e shpërblimit për sportistët e nivelit të lartë dhe trajnerët e tyre jepet me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.

13. Për shpërblimin financiar dhe trajtimin e sportistit të nivelit të lartë, për sportet individuale, që ka arritur rezultate në veprimtaritë ndërkombëtare, sipas tabelës nr. I, federata shqiptare sportive përkatëse aplikon në portalin unik qeveritar "e-Albania". Në aplikim përcaktohet rezultati përfundimtar në veprimtarinë ndërkombëtare, në të cilën sportisti ka marrë pjesë, si dhe deklarimi i federatës që sportisti nuk ka rekorde pozitive të doping-ut, të konfirmuar nga Organizata Kombëtare Antidoping. Ministria përgjegjëse për sportin verifikon përmbushjen e kritereve pas marrjes së kërkesës dhe, në rast të të metave në aplikim, aplikuesi ka të drejtën për plotësimin e tyre brenda afatit shtatëditor.

13/1. Federata duhet të kryejë pagesën e shpërblimit të sportistit dhe trajnerit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga disbursimi i fondeve nga ministria përgjegjëse për sportin.

14. Gjatë vitit kalendarik, përjashtuar periudhën e grumbullimit dhe të pjesëmarrjes në veprimtaritë ndërkombëtare zyrtare të sportistit, sipas tabelës I, sportisti dhe trajneri i tij përfitojnë trajtim ushqimor e mjekësor për përgatitjen sportive dhe pjesëmarrjen në veprimtaritë kombëtare zyrtare.

15. Efektet financiare për shpërblimin e trajtimin e sportistëve të nivelit të lartë dhe trajnerëve të tyre, që arrijnë rezultate në veprimtaritë kombëtare, sipas tabelës II, përballohen nga fondet e njësive të vetëqeverisjes vendore ose të ardhura të tjera të ligjshme. Masa e shpërblimit për sportistët e nivelit të lartë dhe trajnerët e tyre jepet me urdhër të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

16. Për shpërblimin financiar dhe trajtimin e sportistit të nivelit të lartë, për sportet individuale, apo të ekipit sportiv, për sportet kolektive, që kanë marrë vendin e parë në kampionatin kombëtar, organizata sportive përkatëse, që ushtron veprimtarinë në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, paraqet kërkesën pranë saj. Të drejtën për të paraqitur kërkesë e ka edhe sportisti apo trajneri i tij. Kërkesa shoqërohet me rezultatin përfundimtar të federatës shqiptare të atij sporti, referuar kampionatit kombëtar, në të cilin sportisti apo ekipi sportiv ka marrë vendin e parë. Njësia e vetëqeverisjes vendore verifikon përmbushjen e kritereve pas marrjes së kërkesës. Fondet alokohen për organizatën sportive të sportistit/ekipit sportiv dhe trajnerit të tij, për llogari të këtyre të fundit.

17. Sportistët, të cilët kanë përfituar statusin e nivelit të lartë, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 105/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017, 'Për sportin'", trajtohen sipas parashikimeve të këtij vendimi.

17/1. Procedura e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar "e-Albania", zbatohet pasi ministria përgjegjëse për sportin të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare realizimin e shërbimit elektronik. Deri në këtë njoftim, aplikimet do të dorëzohen në formë shkresore pranë ministrisë përgjegjëse për sportin.

18. Vendimi nr. 687, datë 14.11.2018, i Këshillit të Ministrave, "Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë", shfuqizohet.

19. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe organizatat sportive shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Tabela I

VEPRIMTARITË NDËRKOMBËTARE ZYRTARE

Tabela nr. 1:

(Ndryshuar me VKM nr. 829, datë 30.12.2025; zëvendësuar me VKM nr. 296, datë 24.4.2026)

Veprimtaria	Rezultati	Masa e shpërblimit
	Rekord olimpik	**18 000 000 lekë**
	Rekord botëror	**15 000 000 lekë**
	Rekord evropian	**6 000 000 lekë**
	Rekord mesdhetar	**3 000 000 lekë**
	Rekord ballkanik	**1 500 000 lekë**
Lojëra olimpike	Vendi i parë	**15 000 000 lekë**
Lojëra olimpike	Vendi i dytë	**13 000 000 lekë**
Lojëra olimpike	Vendi i tretë	**10 000 000 lekë**
Lojëra olimpike	Vendi i katërt	**6 000 000 lekë**
Lojëra olimpike	Vendi i pestë	**4 000 000 lekë**
Lojëra olimpike	Vendi i gjashtë	**2 000 000 lekë**
Lojëra olimpike	Vendi i shtatë	**1 000 000 lekë**
Lojëra olimpike	Vendi i tetë	**800 000 lekë**

Kampionat botëror	Vendi i parë	**10 000 000 lekë**
Kampionat botëror	Vendi i dytë	**7 000 000 lekë**
Kampionat botëror	Vendi i tretë	**5 000 000 lekë**
Kampionat botëror	Vendi i katërt	**3 000 000 lekë**
Kampionat botëror	Vendi i pestë	**2 000 000 lekë**
Kampionat botëror	Vendi i gjashtë	**1 500 000 lekë**
Kampionat botëror	Vendi i shtatë	**800 000 lekë**
Kampionat botëror	Vendi i tetë	**600 000 lekë**
Kampionat evropian	Vendi i parë	**6 000 000 lekë**
Kampionat evropian	Vendi i dytë	**4 000 000 lekë**
Kampionat evropian	Vendi i tretë	**3 000 000 lekë**
Kampionat evropian	Vendi i katërt	**1 500 000 lekë**
Kampionat evropian	Vendi i pestë	**1 000 000 lekë**
Kampionat evropian	Vendi i gjashtë	**500 000 lekë**
Lojëra mesdhetare	Vendi i parë	**3 000 000 lekë**
Lojëra mesdhetare	Vendi i dytë	**2 000 000 lekë**
Lojëra mesdhetare	Vendi i tretë	**1 000 000 lekë**
Kampionati ballkanik	Vendi i parë	**1 500 000 lekë**

Tabela II

VEPRIMTARITË KOMBËTARE ZYRTARE
(ndryshuar me VKM nr. 167, datë 20.3.2024)

	Rekord kombëtar	**Jo më pak se 200 000 lekë**
Kampionati Kombëtar në Sportet Individuale	Vendi i parë	Jo më pak se 100 000 lekë
Kampionati Kombëtar i Kategorisë më të Lartë në Sportet Kolektive	Vendi i parë	Jo më pak se 500 000 lekë